



Lic.A. Nr. 4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 09.04.2025

Nr. 2748 prot.

Lënda: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ

Drejtuar: Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve

Të nderuar anëtarë të KAS,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me shkresën nr. 55 ID më datë 28.02.2025, depozituar nga Qendra "Qëndresa Qytetare".

Në këtë denoncim Qendra "Qëndresa Qytetare" pretendon si vijon:

"Më datë 20.02.2025, është njoftuar në media se në orën 16:30, Kryeministri do të zhvillonte një takim ku do të merrnin pjesë të detyruar gjithë administrata e Bashkisë Tiranë. Nga verifikimi ynë, në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve (NRI), rezultoi se kjo veprimtari nuk ishte raportuar në KQZ".

Me vendimin nr. 239, datë 06.03.2025, të Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), vendosi fillimin e procedurës administrative, për shqyrtimin e këtij denoncimi.

Në mbështetje të përcaktimit të nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9 datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vijoi hetimin administrativ.

Bazuar në këtë vendim iu kërkua personave përgjegjës pranë Kuvendit të Shqipërisë, për raportimin e veprimtarive publike, që të paraqesin prapësimet në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Neni 92, pika 1, e Kodit Zgjedhor parashikon se: *"Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre."*

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe në mbështetje neneve 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", nenet 92, 171 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",



të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar, i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative ndaj:

- Z. Alban Dokushi, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Tiranë, në vlerën 1 000 (një mijë) lekë, referuar nenit 171, pika 2, e Kodit Zgjedhor.

Nga të dhënat që disponohen rezulton se subjekti është përsëritës për shkeljen.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosje të sanksionit administrativ, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:

- Vendim nr. 438, datë 08.04.2025, "Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 55ID, datë 28.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Qendrës "Qëndresa Qytetare";
- Denoncim nr. 55 ID, datë 12.02.2025, depozituar nga Qendra "Qëndresa Qytetare";
- Korrespondenca elektronike, me subjektin denoncues Bashkia Tiranë, Kryeministria dhe Qendra "Qëndresa Qytetare.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan ÇELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 08.04.2025

Nr: 438

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV BAZUAR NË DENONCIMIN NR. 55 ID,
DATË 28.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË QËNDRËS
“QËNDRESA QYTETARE”**

Sot më datë 08.04.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mori në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Qendra “Qëndresa Qytetare”

SUBJEKT: **Z. Engjël Agaçi**
Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave

Z. Alban Dokushi
Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Tiranë

OBJEKT: Mosraportim i veprimtarisë publike takim me punonjësit e Bashkisë Tiranë

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neni 92, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pika 5, neni 5, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Data: 08.04.2025 Nr: 438

Ora: 12:00



Shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 55 ID,
Datë 28.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Qendrës
“Qëndresa Qytetare”

Qendra "Qëndresa Qytetare" më datë 28.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 55 ID.

"Në këtë denoncim Qendra "Qëndresa Qytetare" parashtrohet sa vijon: "Më datë 20.02.2025, është njoftuar në media se në orën 16:30, Kryeministri do të zhvillonte një takim ku do të merrnin pjesë të detyruar gjithë administrata e Bashkisë Tiranë. Nga verifikimi ynë, në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve (NRI), rezultoi se kjo veprimtari nuk ishte raportuar në KQZ".

Me vendimin nr. 239, datë 06.03.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u vendos fillimi i procedurës administrative, për shqyrtimin e këtij denoncimi. Bazuar në këtë vendim iu kërkua personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, pranë Kryeministrit dhe Bashkisë Tiranë, që të paraqesin prapësimet në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Më datë 06.03.2025, KQZ administroi pretendimet e personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, nga Kryeministria, si vijon:

"Më datë 12.2.2025, personi përgjegjës për raportimet e institucionit të Kryeministrit ka raportuar veprimtarinë: Ceremoninë e hapjes "Tirana, Kryeqytetit Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025", me të ftuar autoritete vendase dhe të huaja, si dhe praninë e Kryeministrit z. Edi Rama. Më datë 19.2.2025, personi përgjegjës për raportimet e veprimtarive publike në Kryeministri ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike KQZ-në se nuk mund të kryeshin ndryshime në sistem lidhur me vendndodhjen e aktivitetit nga TKOB në Sheshin Skënderbej në orën 16:00. Sikundër është raportuar Kryeministri është në cilësinë e të ftuarit dhe nuk është Kryeministria që e organizon aktivitetin".

Më datë 07.03.2025, ora 14:00, u zhvillua seanca publike për këtë shqyrtim administrativ.

Në kuadër të hetimit administrativ, pas zhvillimit të seancës publike të datës 07.03.2025, dhe pasi u dëgjuan pretendimet e përfaqësueses së Kryeministrit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i kërkoi personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të vendosin në funksion të hetimit administrativ ftesën e organizatorit të kësaj veprimtarie publike. Nga prova e administruar "Ftesë" rezultoi se organizatori i veprimtarisë "Tirana, Kryeqytetit Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025", është bashkia Tiranë.

Më datë 17.03.2025, kemi administruar përgjigjen e personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tiranë, i cili bën me dije se:

"Takimi i datës 20.02.2025, me pjesëmarrjen e kryeministrit z. Edi Rama, nuk është raportuar në ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve (NRI), nga ana e Bashkisë Tiranë, pasi takimi është organizuar në formën e një mbledhjeje me stafin e Bashkisë dhe institucionet e saj të varësisë, për shkak të situatës së vështirë në të cilën ndodhej institucioni i bashkisë dhe jo në formën e një veprimtarie publike me pjesëmarrjen e publikut."

Data:08.04.2025 Nr: 438

Ora: 12:00



Shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 55ID, Datë 28.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Qendrës "Qëndresa Qytetare"

Gjithashtu më datë 15.03.2025, kemi administruar disa pretendime shtesë nga ana e denoncuesit si vijon: "Aktiviteti i denoncuar është aktiviteti i ndryshëm nga ai i raportuar. Ky fakt mbështetet dhe nga vetë faqja zyrtare e Kryeministrit. Për më tepër, aktiviteti "Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025", me të njëjtët pjesëmarrës është zhvilluar në të njëjtin ambient, në datën 12 mars 2025, fakt që provohet nga link-u vijues: https://www.youtube.com/watch?v=d_PHIE_7C10

Më datë 28.03.2025, ora 13:00, u zhvillua seanca publike për këtë shqyrtim administrativ.

Gjatë hetimit administrativ u provua se veprimtaria publike "Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025", është raportuar më datë 14.02.2025, nga personi përgjegjës pranë Kryeministrit, për tu zhvilluar më datë 20.02.2025.

Më datë 19.02.2025, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Kryeministrit, ka raportuar ndryshimin e vendndodhjes së veprimtarisë publike nga TKOB në Sheshin "Skënderbej", në orën 16:30.

Rezultoi se veprimtaria publike e raportuar për tu zhvilluar më datë 20.02.2025, ora 16:30, është zhvilluar më datë 12.03.2025.

Në lidhje me takimin e datës 20.02.2025, zhvilluar në sheshin "Skënderbej", të punonjësve të bashkisë Tiranë me Kryeministrin, provohet se kjo veprimtari publike rezultoi e paraportuar në ndërfaqen e Raportimeve NRI.

Për këto arsye, vlerësoj se gjatë hetimit administrativ, u arrit të provohej shkelja e pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 10, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, ndaj referuar nenit 171, pika 2, të Kodi Zgjedhor, kur shkelja nuk përbën veprë penale, dënohet me gjobë nga 1 000 (njëmijë) deri në 2 500 (dymijë e pesëqind) lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" dhe pika 2, nenin 92, pika 1, nenin 171, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 10, pika 1, të vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar

V E N D O S:

1. T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative ndaj:
 - Z. Alban Dokushi, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Tiranë, në vlerën 1 000 (një mijë) lekë;

Data:08.04.2025 Nr: 438

Ora: 12:00



Shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 551D,
Datë 28.02.2025, të regjistrimit të denoncimeve, të Qëndrës
"Qëndresa Qytetare"

2. Pushimin e shqyrtimit administrativ ndaj z. Engjëll Agaçi, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data:08.04.2025

Nr: 438

Ora: 12:00



Shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 55ID,
Datë 28.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Qendrës
"Qëndresa Qytetare"

By Date

denoncime
To: Suzana Nezaj, Alban Dokushaj, nensia.boardha@tirana.ai
Cc: Qendresa Qytetare
Bcc: Pavlina Docaj, Aurel Lamce

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>
Sent: Tuesday, March 4, 2025 3:38 PM
To: Suzana Nezaj <Suzana.Nezaj@krveminstira.ai>
Cc: Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>
Subject: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. 55 ID

Përshëndetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 28.02.2025, është administruar denoncimi regjistruar me nr. 55 ID, i përcjellë nga Organizata Qendra "Qendresa Qytetare".

Në këtë denoncim Qendra "Qëndresa Qytetare" parashtoi sa vijon:

"Më datë 20.02.2025, Qendra "Qëndresa Qytetare" është njoftuar përmes platformave të komunikimit elektronik dhe të mediave të ndryshme se në të njëjtën datë, në orën 16:30 Kryemiku do të marrim pjesë të detyruar gjithë administrata e Bashkisë Tiranë. Nga verifikimi ynë, në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve (NRI), rezultoi se kjo veprimtari nuk ishte bërë publike, takimi i Kryeministrit ka filluar në orën 16:30. Fjala e hapjes është mbajtur nga zj. Anuela Ristani e cila në mënyrë të përmbledhur falënderon Kryeministrin për takimin dhe punën për mbartëveshjen e punëve publike. Në fjalimin e Kryeministrit janë mbajtur qëndrime të një natyre politike, duke përdorur veprimtarinë publike për të zhvilluar propagandën dhe i organizuar në orën 16:30, ndryshe nga sa pretendon KQZ, nuk është raportuar nga ana e Kryeministrit. Gjithashtu në këtë aktivitet janë bërë ndryshime lidhur me pjesëmarrësit në të".

Punonjësit e Bashkisë Tiranë dhe institucioneve në varësi të saj kanë marrë pjesë në këtë veprimtari gjatë periudhës katër mujore përpara datës së zgjedhjeve dhe zhvillimi i saj nuk është i autorizuar nga Komisioni i Zgjedhjeve vendosi fillimin e hetimit administrativ.

Bazuar në nenin 91 dhe 169 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe Kodit të Procedurave Administrative, kërkojmë nga ana juaj, lidhje me denoncimin që i përket institucionit Tujaj, si dhe çdo provë mbi rastin objekt hetimi administrativ, brenda 48 (dyzetë e tetë) orëve.

Bashkëlidhur po ju vërnë në dispozicion denoncimin e administruar nga ana jonë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



- 3/17/2025
- 3/18/2025
- 3/20/2025
- 3/20/2025
- 3/27/2025
- Mon 11:08 ...
- 2/28/2025
- 2/28/2025

By Date ↑ Re: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. 55 ID

denoncime To: Suzana Nezaj, Alban Dokushy, nensibardha@tirana.ai Cc: Qendresa Qytetare Bcc: Pavlina Docqaj, Aural Lance

From: Suzana Nezaj <Suzana.Nezaj@kyeministria.ai> Sent: Thursday, March 6, 2025 4:42 PM To: denoncime <denoncime@kqz.gov.al> Subject: Re: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. 55 ID

KOMISIONERIT SHPETËROR TË ZGJEDHJEVE KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TIRANË

Në datën 4.3.2025, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Kryeministri është njoftuar nga KQZ se është depozituar Denoncimi me nr. 55 ID: Denoncues: Organizata Qendra "Qëndresa Qytetare" Kundër: Z. Engjell Agaçi, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave Z. Edi Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

Çdo personi tjetër, të pайдentifikuar deri më tani nga ana jonë, por që me veprime konkrete rezultojn se ka përgjegjësi

Objekti:

- 1. Vendosja e sanksionit administrativ ndaj Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave
2. Vendosja e sanksionit administrativ Z. Edi Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, për pengimin e raportimit të veprimtarisë publike, takim me punonjësit
3. Vendosja e sanksionit administrativ çdo personi tjetër, të pайдentifikuar deri më tani nga ana jonë, por që me vprime konkrete rezultojn se ka përgjegjësi administrativ

Pasi u njohëm me denoncimin e bërë, brenda afatit prej 48 orësh nga marrja djeteni, prapësojmë si më poshtë vijon:

Brethanat e faktit:

- Më datë 14.2.2025, personi përgjegjës për raportimet të Institucionit të Kryeministrit, ka raportuar në përputhje me afatet ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor, dy Ceremonia e Hapjes "Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025". Në këtë ceremoni janë ftuar të marrin pjesë autoritete vendore dhe të huaj, ceremoni në të ftuar edhe Kryeministri i vendit Z. Edi Rama. Veprimtaria është raportuar në datë 14.2.2025 për t'u zhvilluar në datë 20.2.2025, ora 16:00, Vendi i zhvillimit të veprimtarisë: TK
Në datë 19.2.2025, personi përgjegjës për raportimet e veprimtarive publike në Kryeministri ka njoftuar via mail KQZ-në se veprimtaria publike "Ceremonia e Hapjes Kulturës dhe Dialogut 2025" për shkak të afërsisë së eventit është e pamundur ndryshimi në sistem i vendit ku do organizohet aktiviteti. Nga TKOB, vëndndodhjet "Skënderbej", në orën 16:30, po në njësinë administrative nr. 2, Tiranë.

Re: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. **55 ID**

denoncime
To ● Suzana Nezaj ● Alban Dokushaj ● nensibardha@tirana.al
Cc ● Qendresa Qytetare
Bcc ● Pavlina Docajj ● Aurel Lance

● Komisioneri shtetëror i zgjedhjeve, pasi ka administruar kërkesën e Organizatës Qendra "Qëndresa Qytetare" për ndalimin e veprimtarisë me vendimin nr. 129, datë 20.2.2020, në emër të Komisionit Rregullator, i ndryshuar nga Institucioni i Kryeministrit dhe njoftimi për ndryshimin e kohës dhe vendit të organizimit të tyre elektronikë. Tematikat e veprimtarive të raportuara nga Institucioni i Kryeministrit nuk hynë në fushën e veprimtarive të ndaluara, të parashikuara nga neni 92, I Kodit Zgjedhor të Komisionit Rregullator, i ndryshuar. Këto veprimtari janë raportuar në përputhje me parashikimet ligjore më sipër, e për rrjedhojë, nuk ka vend për ndalimin e secilës prej këtyre dy veprimtarive të Komisionit Rregullator, i ndryshuar nga Institucioni i Kryeministrit dhe njoftimi për ndryshimin e kohës dhe vendit të organizimit të tyre elektronikë. Mospranimin e kërkesës së Organizatës Qendra "Qëndresa Qytetare", për ndalimin e veprimtarisë publike, "Takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë".

Argumentimi:

Veprimtaria e zhvilluar në datën 20 shkurt 2025, në orën 16:30, është një veprimtari me karakter publik në kuptim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe të shkrimit nr. 9/2020, të ndryshuar të Komisionit Rregullator.

Personi përgjegjës në institucionin e Kryeministrit, ka kryer raportimin e veprimtarisë në zbatim të të gjithë rregullave procedurale të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe Vendimin nr. 9/2020, të ndryshuar të Komisionit Rregullator.

Lidhur me procedurën e ndjekur vlerësojmë se raportimi është kryer brenda afatit ligjor, 5 ditë përpara zhvillimit të tij. Sikundër edhe është cilësuar në raportim, Kryeministri është në cilin funksion të Komisionit Rregullator, i ndryshuar nga Institucioni i Kryeministrit dhe njoftimi për ndryshimin e kohës dhe vendit të organizimit të tyre elektronikë. Në funksion të bërjes transparente për veprimtarinë publike, personi përgjegjës për raportimin ka njoftuar menjëherë KQZ, për zhvillimit të veprimtarisë dhe të orës.

Pra referuar kronologjisë së fakteve dhe rrethanave rezultoi se Kryeministria ka respektuar afatet dhe procedurat e raportimit lidhur me aktivitetin në fjalë.

Sipas nenit 92 të Kodit Zgjedhor, raportimi i veprimtarive publike duhet të bëhet në ndërfaqen e raportimit, dhe ky informacion duhet të jetë i aksesueshëm për të gjithë përdoruesit të Komisionit Rregullator parashikon që raportimi i veprimtarive bëhet jo më vonë se 5 ditë para zhvillimit të tyre, dhe në këtë rast, raportimi është kryer brenda afatit nga Kryeministria dhe Komisioni Rregullator.

Sipas vendimit 9/2020, raportimi nuk mund të modifikohet brenda 5 ditëve para aktivitetit, por nuk përjashtohet që KQZ të marrë në shqyrtim ndryshime teknike dhe të japë miratim i cili ka transparençë.

Vetë vendimi 9/2020 në nenin 5 përcakton se "NRI mund të lejojë raportimin e një veprimtarie e cila nuk plotëson kushtin e pikës 1 të këtij Kreu, por automatikisht kjo veprimtari përveç KSHZ nuk ka marrë një vendim për ta lejuar atë".

Në këtë rast, Kryeministria ka komunikuar me KQZ për ndryshimin e vendndodhjes, duke siguruar transparencë dhe duke respektuar qëllimin e dispozitave ligjore për informimin publik të veprimtarive publike, të cilat janë të shprehura në dispozitave ligjore të Komisionit Rregullator, i ndryshuar nga Institucioni i Kryeministrit dhe njoftimi për ndryshimin e kohës dhe vendit të organizimit të tyre elektronikë.

Nëse do të supozonim një situatë të ngjashme, pra, vendndodhja të ishte përcaktuar në sheshin Skënderbej, por për shkak të teknikës, si ato logjistike, atmosferike apo sigurie, të detyron sponsoreshin në një ambient të mbyllur, ky element nuk është shprehur nga detyrimi ligjor dhe as përmban qëllim në vetvete për të devijuar nga dhënia e plotë e informacionit, në zbatim të dispozitave ligjore të Komisionit Rregullator, i ndryshuar nga Institucioni i Kryeministrit dhe njoftimi për ndryshimin e kohës dhe vendit të organizimit të tyre elektronikë. Në të kundërt, do të qëndroshim përpara çështjes së parimit të proporcionalitetit. Rasti objekt shqyrtimi, pra veprimtaria publike e raportuar dëshmon pikërisht vullnetin e Komisionit Rregullator, i ndryshuar nga Institucioni i Kryeministrit dhe njoftimi për ndryshimin e kohës dhe vendit të organizimit të tyre elektronikë, për të siguruar informimin publik të veprimtarive publike, të cilat janë të shprehura në dispozitave ligjore të Komisionit Rregullator, i ndryshuar nga Institucioni i Kryeministrit dhe njoftimi për ndryshimin e kohës dhe vendit të organizimit të tyre elektronikë.

By Date	↓
31/...	Mon 11:08 ...
31/...	3/27/2025
31/...	3/20/2025
31/...	3/18/2025
31/...	3/17/2025
31/...	3/15/2025
31/...	2/28/2025
31/...	2/28/2025

By Date

3/11/2025 Mon 11:08 ...

denoncime To: Suzana Neraçi, Alban Dokushi, nensibardha@tirana.ai Cc: Qendresa Qytetare Bcc: Pavlina Docaj, Aurel Lamce

Re: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. 55 ID dhe informimit. Në të kundërt, do të gjendeshim përpara çenimit të parmit të proporcionalitetit. Rasti objekt shqyrtimi, pra veprimtaria publike e raportuar dëshmon pikërisht vullnet për të informuar si institucionin përgjegjës, KQZ, ashtu edhe publikun e interesuar.

Për sa kohë është raportuar ndryshimin tek KQZ dhe është marrë miratim, ky veprim është në përputhje me parimet e transparencës dhe nuk përbën shkelje formale të raportimit.

Denoncuesi, në argumentin e tij, pretendon se veprimtaria e zhvilluar në datën 20 shkurt 2025 është e ndryshme nga ajo e raportuar. Denoncuesi pretendon se ndryshimi i venddodhjeve minuta përbën shkak për ta klasifikuar veprimtarinë e zhvilluar si të ndryshme nga ajo e raportuara.

Sjellim në vëmendje se Kryeministri është ftuar për të marrë pjesë në aktivitetin e bashkisë Tiranë, Ceremonia e Hapjes "Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025". Një personi përgjegjës për raportimet në Kryeministri, në vlerësimin e tij e ka klasifikuar si një veprimtari publike në kuptim të Kodit Zgjedhor dhe e ka raportuar, pavarësisht se është as organizator dhe as bashkëorganizator i veprimtarisë.

Ndonëse ligji dhe vendimi 9, ia atribuojnë detyrimin për raportim organizatorit apo bashkëorganizatorëve, nuk përcaktohet penalizim apo sanksionim për personat e ftuar në rast se re Denocuesi pretendimin e tij e bazon në fjalimin e mbajtur nga Kryeministri si një prej të ftuarve kryesorë në këtë veprimtari. Duam të sjellim në vëmendjen tuaj se retorika e artikullit shkëputur nga konteksti, nuk përbën shkak ligjor për ta klasifikuar këtë veprimtari si jo të përputhur me tematikën e saj. Një fjalim synon të nxisë refleksim ndërmjet pjesëmarrësve dhe lidhje të reja mes tematikës dhe fushave të tjera, duke e hapur diskutimin për ide të reja apo këndvështrime të tjera.

Nuk ekziston një detyrim ligjor që të shtrengojë folësin në qasje strikte me tematikën e një aktiviteti. Një zyrtar është i lirë dhe spontan në fjalën e tij dhe në mënyrën që kërkon të përcaktuar në 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut garanton lirinë e shprehjes Qdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë duke përfshirë edhe lirinë e një zyrtari publik për të përshtatur retorikën në një aktivitet të caktuar. Siguria juridike kërkon që ndalimet të jenë të qarta dhe të parashikuara saktë.

Nëse do të interpretohet ngushtësisht ligji, do të mund të gjendeshim përballë situatave absurde kur edhe fjalimet e të ftuarve do të duhej të kishin kritere dhe indikatorë të matshëm përpara mesuesit të historisë.

Në asnjë dispozitë të Kodit Zgjedhor apo të vendimit nr.9/2020 nuk thuhet se një ndryshim i retorikës gjatë një aktiviteti përbën shkelje, për sa kohë që aktiviteti në vetvete nuk shkel rregullat publike në fushatë.

Ajo që vlerësojmë është se aktiviteti është raportuar, publiku është informuar ashtu sikundër edhe palët e interesuara, për të vlerësuar nëse ky aktivitet është zhvilluar në kundërshtim me parimet e burimeve shtetërore.

Argumenti i Qendresës Qytetare se retorika e ndryshon natyrën e takimit nuk ka bazë ligjore, pasi fjalimi i një të ftuari është subjektiv dhe fleksibel, për sa kohë ai nuk përmban thirrje subjektive zgjedhor apo kandidatë.

Gjithashtu nuk ekziston një dispozitë ligjore që fikson detyrimisht pjesëmarrësit në një aktivitet publik nga momenti i raportimit deri në zhvillimin e tij. Sipas parimit të fleksibilitetit administrativ, institucionale mund të përshtatet bazuar në rrethanat të ndryshme, si disponueshmëria e zyrtarëve, nevoja për përfaqësim të ndryshëm apo dinamika e procesit vendimmarrës. Ndryshimet në ligjshmëri dhe aktivitetit, për sa kohë ai nuk e transformon natyrën e tij në një ngjarje të pastër politike ose elektorale.

Aktiviteti i zhvilluar nuk përbën një "veprimtari të ndaluar" sipas Nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

Re: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. **55 ID**

denoncime
To Suzana Nezaj Alban Dokushy nensi.bardha@trana.ai
Cc Qendresa Qytetare
Bcc Pavlina Docaji Aurd Lance

Institucionale mund të përshtatet bazuar në rrethana të ndryshme, si disponueshmëria e zyrarëve, nevoja për përfqësim të ndryshëm apo dinamika e procesit vendimmarrës. Ndrysh në ligjshmërinë e aktivitetit, për sa kohë ai nuk e transformon natyrën e tij në një ngjarje të pastër politike ose elektorale.

Aktiviteti i zhvilluar nuk përbën një "veprimtari të ndaluar" sipas Nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

Veprimtaria publike e ndaluar është ajo që: Përdor burime shtetërore për qëllime elektorale dhe ka karakter politik apo favorizon një subjekt zgjedhor; Cënon parimin e barazisë në zgjedhje për një palë të caktuar; Përdoret për të promovuar individë që janë kandidatë në zgjedhje.

Në këtë rast, nuk ka asnjë provë që aktiviteti: Ka pasur qëllime elektorale ose promovuese për një subjekt zgjedhor; Ka përdorur burime shtetërore për qëllime të fushatës zgjedhore padrejte një kandidat ose një parti politike.

Sipas praktikës së Komisionit të Venecias mbi ndarjen mes funksioneve shtetërore dhe politike, një aktivitet publik duhet të gjykohet mbi thelbin e tij, jo mbi fleksibilitetin e diskutit b Ndryshimi i retorikës nuk transformon natyrën ligjore të aktivitetit për sa kohë që:

- Ai mbetet në kuadrin e kompetencave institucionale.
- Nuk ka përdorim të burimeve publike/shtetërore për fushatë elektorale.
- Vleresojme se lloji i komunikimit publik të një zyrtari duhet të interpretohet në kontekstin e detyrave të tij shtetërore për sa kohë nuk ka thirrje direkte për mbështetë kandidat.
- Ndryshimi i plesëmarrësve duhet të analizohet në lidhje me efektin që ka mbi aktivitetin dhe jo si një qështje formale e raportimit paraprak

Për më tepër, aktiviteti është zhvilluar në mënyrë transparente, është raportuar në KQZ brenda afatëve, dhe është miratuar nga autoriteti përgjegjës (Komisioneri).

Konkluzione:

1. Aktiviteti është raportuar brenda afatëve dhe ka qenë transparent.
2. Kryeministria edhe pse në cilësimin e institucionit të fuar ka njoftuar KQZ-në për ndryshimin e vendit dhe ka marrë miratimin e saj.
3. Nuk parashikohet sanksionim për personin përgjegjës për raportimet në rastet kur raporton një veprimtari për të cilën nuk është organizator apo bashkëorganizator.
4. Pretendimi i Qendresës Qytetare se për shkak të retorikës së një të fuari veprimtaria është e ndryshme nga ajo e raportuar, është një interpretim i gabuar i ligjit, për sa ka publike për qëllime elektorale apo thirrje të drejtpërdrejta në funksion të zgjedhjeve të 11 Majit 2025.

Për këto arsye, kërkojmë rrezimin e denoncimit dhe kërkesës si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Punë të mbarë,

Suzana

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

By Date	↓
Mon 11:08 ...	↩
3/27/2025	↩
3/20/2025	↩
3/18/2025	↩
3/17/2025	↩
3/15/2025	↩
2/28/2025	↩
2/28/2025	↩

By Date ↑

Re: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. **55 ID**

denoncime
 To: Suzana Nezaj, Alban Dokushi, nensibardha@tirana.al
 Cc: Qendresa Qytetare
 Bcc: Pavlina Docaj, Aural Lamce

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>
 Sent: Thursday, March 20, 2025 10:39 AM

To: Suzana Nezaj <Suzana.Nezaj@Kryeministria.al>; Alban Dokushi <alban.dokushi@tirana.al>; nensibardha@tirana.al <nensibardha@tirana.al>
 Cc: Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>

Subject: Re: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. **55 ID**

Përsëritëditje,

Ju njoftojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, do të zhvillojë seancë publike, mbi vijimin e hetimit administrativ të shtyrë nga seanca publike e datës 07.03.2025.

Mbështetur në përcaktimet e nënt 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", ju kenit të drejtën të paraqitjen vetë ose me mbrojtës ligjor për të dhënë shpjegime 21 Mars 2025, ora 12:00, në adresë Rr. "Ibrahim Rugova", nr. 4, Tiranë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime

Sent: Saturday, March 15, 2025 12:24 PM

To: Suzana Nezaj <Suzana.Nezaj@Kryeministria.al>

Cc: Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>

Subject: Re: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. **55 ID**

Përsëritëditje,

Në vijim të hetimit administrativ, mbështetur në pretendimet e depozituara nga ana juaj, nepermjet se cilit theksohet fakti se Kryeministri ka gene ne cilesine e te ftuarit ne kete veprimtari pub dispozion ftesen e organizatorit te veprimtarise publike, duke gene se pretendimet tuaja cihet se "*Ceremonia e Hapjes "Tirana, Kryeqyteti. Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025". Në këtë auto rthete vendose dhe te huaj, ceremoni në të cilën do të jetë i pranishëm si i ftuar edhe Kryeministri i vendit Z. Edi Rama. Veprimtaria është raportuar në datë 14.2.2025 për t'u zhvilluar në c zhvillimit të veprimtarisë: TKOB, njësit administrative nr. 2".*

Mbetemi ne pritje te nje pergjigje nga ana juaj, brenda dates 17.03.2025.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

By Date ↑

denoncime
To: Suzana Nezaj, Alban Dokushi, nensibardha@tirana.al
Cc: Qendresa Qytetare
Bcc: Pavlina Docaj, Aurel Lamce

Re: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. 55 ID

Pershendetje,

Ju njoftojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka përfunduar hetimin administrativ ndaj Institucionit Tuj dhe do të vijojë me shpalljen e vendimit për denoncimin regjistruar me nr. 55 ID të datës 21.03.2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>
Sent: Thursday, March 27, 2025 10:06 AM
To: Suzana Nezaj <Suzana.Nezaj@kryeministria.al>; Alban Dokushi <alban.dokushi@tirana.al>; nensibardha@tirana.al <nensibardha@tirana.al>
Cc: Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>

Subject: Re: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. 55 ID

Përsihendetje,

Ju njoftojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, do të zhvillojë seancë publike, mbi vijimin e hetimit administrativ të shtyrë nga seanca publike e datës 21.03.2025.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", ju këni të drejtën të paraqiteni vetë ose me mbrojtës ligjor për të dhënë shpjegime të kërkesës së depozitimit të pretendimit të denoncimit regjistruar me nr. 55 ID të datës 28 Mars 2025, ora 13:00, në adresë Rr. "Ibrahim Rugova", nr. 4, Tiranë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>
Sent: Thursday, March 20, 2025 10:39 AM
To: Suzana Nezaj <Suzana.Nezaj@kryeministria.al>; Alban Dokushi <alban.dokushi@tirana.al>; nensibardha@tirana.al <nensibardha@tirana.al>
Cc: Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>
Subject: Re: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. 55 ID

Fw: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. 55 ID

denoncime To rensibardha@tirana.al

If there are problems with how this message is displayed, click here to view it in a web browser.

Per njohte

From: Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>

Sent: Saturday, March 15, 2025 4:13 PM

To: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Cc: Suzana Nezaj <Suzana.Nezaj@kryeministria.al>

Subject: Re: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. 55 ID


KUJDES: Ky eshte nje email i ardhur nga jashte adresave zyrtare qeveritare. Mos klikoni URL-te ose bashke lidhjet nese nuk e njihni dhe/ose nuk i besoni derguesit. Përshtendetje,

Pasi jemi njohtur me pretendimet e Kryeministres dhe me vijimin e hetimit administrativ, përmbledhtazi sqarojmë se:

1. Së pari, në lidhje me pretendimin mbi ndryshimin e vendndodhjes së aktivitetit, sikundërse vetë Kryeministria e pranon, Vendimi nr. 9/2020, i Komisionit Rregullator në pikën 6, të modifikimit të të dhënave në periudhën 5 (pesë) ditore përpara datës së aktivitetit deri në datën e zhvillimit të tij. Kjo dispozitë është një dispozitë ndaluese dhe si e tillë, zbatimi i në çdo rast. Për analogji, sikundër një student nuk mund të ndryshojë pyetjet e provimit pasi i lexon ato apo datën e provimit, edhe një institucion nuk mund të ndryshojë përmtë të përcaktuara nga ligji.
2. Së dyti, në rastin konkret, provohet katërcipërisht se aktiviteti i denoncuar është aktiviteti i ndryshëm nga ai i raportuar për disa arsye. Fillimisht, në të njëjtën datë dhe në të njëjtën adresë, kryeministria e përcaktoi adresën e aktivitetit si "TAKIM ME PUNONJËSIT E BASHKISË TIRANË", fakti që ky aktivitet është një aktivitet i ndryshëm nga ai i denoncuar është e qartë nga fakti që ky aktivitet është regjistruar në datën 12 mars 2025, fakt që provohet nga link-u vijues: [https://www.ph1e.gov.al/PH1E-7C10](#)

Përsa më sipër, kërkojmë administrimin në cilësinë e provës edhe të videos që gjendet në link-un e sipërcituar.

Më të mirat,



QENDRESA QYTETARE

Rruga "Ali Pashë Gucia 1", Tiranë
www.qq.com.al
qendresaqytetare@gmail.com



Results By Date ↑

denoncime Fw: Kerkese per depozitim Per njoftje 3/20/2025 Sent Items

denoncime Re: Kerkese per depozitim Pershendetje, Ju 3/20/2025 Sent Items

denoncime Fw: Kerkese per depozitim 3/18/2025 Sent Items

Suzana Nezaj Re: Kerkese per depozitim Pershendetje, ne 3/17/2025 Inbox

denoncime Fw: Fw: Kerkese per depozitim Per njoftje 3/17/2025 Sent Items

nensibardha@tirana... Re: Fw: Kerkese per depozitim KUIDES: Ky është një 3/17/2025 Inbox

Last Month

Qendresa Qytetare Re: Kerkese per depozitim KUIDES: Ky është një 3/15/2025 Inbox

denoncime Fw: Kerkese per depozitim Pershendetje, Plane 3/15/2025 Sent Items

denoncime Re: Kerkese per depozitim Pershendetje, Ne 3/15/2025 Sent Items

denoncime Re: Kerkese per depozitim Pershendetje, Ne 3/15/2025 Archive

denoncime Re: Kerkese per depozitim Pershendetje, Ju 3/16/2025 Archive

Re: Fw: Kerkese per depozitim pretendimesh per denoncimin regjistruar me nr. 55 ID

nensibardha@tirana.al To denoncime Cc Qendresa Qytetare; Alban Dokushi

You forwarded this message on 3/17/2025 5:40 PM. Click here to download pictures. To help protect your privacy, Outlook prevented automatic download of some pictures in this message.

denoncim 55.docx 16 KB

KUIDES: Ky është një email i ardhur nga jashtë adresave zyrtare qeveritare. Mos klikoni URL-të ose bashkëlidhjet nese nuk e njihni dhe/ose nuk i besoni degje

Pershendetje,

Bashkeidhur gjemi materialin me pretendimet e Bashkise Tirane lidhur me denoncimin regjistruar me nr. 55 ID, nga Qendra "Qendresa Qytetare".

Pune te mbare!

Nensia BARDHA Specialist

Sektori Asistences Ligjore dhe Legjislacionit Drejtoria Juridike Bashkia Tirane

Sheshi "SKENDERBEJ", Nd. 2, Kodi postar 10011, Tirane, Shqipëri

March 15, 2025 12:27 PM. "denoncime" <denoncime@kqz.gov.al> wrote:

Përshendetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 28.02.2025, është administruar denoncimi regjistruar me nr. 55 ID, i përcjellë nga Organizata Qendra "Në këtë denoncim Qendra "Qendresa Qytetare" parashtrohet sa vijon:

"Më datë 20.02.2025, Qendra "Qëndresa Qytetare" është njoftuar përmes platformave të komunikimit elektronik dhe të mediave të ndryshme se në Kryeministri do të zhvillohete një takim ku do të merren pjesë të detyruar gjithë administrata e Bashkisë Tirane. Nga verifikimi ynë, në Ndërfaqen Elektronik (NRI), rezultoi se kjo veprimtari nuk ishte raportuar në KQZ. Sikundër është bërë publike, takimi i Kryeministrit ka filluar në orën 16:30. Fjala e hapjes është e cila në mënyrë të përmblodhur falenderon Kryeministrin për takimin që në këndvështrimin e saj përben një sfidë për mbartëvajtjen e punëve publike. mbajtur qëndrimin të një natyre politike, duke përdorur veprimtarinë publike për të zhvilluar propagandë elektorale. Aktiviteti publik i organizuar në orën 1 KQZ, nuk është raportuar ana e Kryeministrit. Githashtu në këtë aktivitet janë bërë ndryshime lidhur me pjesëmarrësit në të".

Punonjësit e Bashkisë Tirane dhe institucioneve në varësi të saj kanë marrë pjesë në këtë veprimtari gjatë periudhës katër mujore përpara datës së zgjedhjeve.

Përsshëndetje,

Në vijim të denoncimit të regjistruar me nr. 55 ID, nga Organizata Qendra "Qëndresa Qytetare", ju sqarojmë si më poshtë vijon:


Takimi i datës 20.2.2025, me pjesëmarrjen e kryeministrit z. Edi Rama, **nuk është raportuar në ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve (NRI)**, nga ana e Bashkisë Tiranë, pasi takimi është organizuar në formën e një mbledhjeje me stafin e Bashkisë dhe institucionet e saj të varësisë, për shkak të situatës së vështirë në të cilën ndodhej institucioni i bashkisë **dhe jo në formën e një veprimtarie publike** me pjesëmarrjen e publikut në kuptim të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të ndryshuar.

Në vijim, sjellim në vëmendjen tuaj se sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, roli i kryeministrit është i përcaktuar kryesisht nga **Kushtetuta e Shqipërisë dhe ligjet e tjera që rregullojnë funksionimin e administratës publike dhe pushtetit ekzekutiv**.

Gjithashtu, kryeministri edhe pse është më së shumti i fokusuar në udhëheqjen dhe menaxhimin e pushtetit qendror, ai ka një rol indirekt dhe mbështetës **në fuqizimin e pushtetit vendor**. Kryeministri ka gjithashtu një rol të rëndësishëm në koordinimin dhe sigurinë e zbatimit të ligjeve dhe politikave që ndikojnë në zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve të pushtetit vendor.

Për sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë situatën me të cilën u përball Bashkia Tiranë (bashkia më e madhe në vend si për nga popullsia, ashtu edhe nga territori) ishte e domosdoshme që kreu i qeverisë, të ofronte mbështetjen e tij për motivimin e punonjësve me qëllim vijimin e proceseve të punës duke mbajtur në konsideratë parimin e kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë komunitetit, i njohur ndryshe si parimi i “Subsidiaritetit”.

Për sa i përket eventit "Ceremonia e Hapjes “Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025”, ky event është raportuar në ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve (NRI) dhe është zhvilluar më datë 12.3.2025.





Tiranë, më datë 28.02.2025

KALLËZIM

KALLËZUES:

Qendra “Qëndresa Qytetare”, një organizatë jofitimprurëse e regjistruar me Vendimin Nr. 1120, datë 15.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Rruga “Ali Pashë Gucia”, Pallati nr. 42 me adresë elektronike qendresaqytetare@gmail.com, me Drejtor Ekzekutiv Z. Rigels Xhemollari, përfaqësuar me autorizim nga Z. Dhimitër Zguro.

KUNDËR:

1. Z. Engjëll Agaçi, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.
2. Z. Edi Rama, me detyrë Kryeministër i Republikës së Shqipërisë.
3. Dhe çdo personi tjetër, të pa identifikuar deri më tani nga ana jonë, por që me veprime konkrete rezultojn se ka përgjegjësi administrative.

OBJEKTI:

1. Vendosja e sanksionit administrativ ndaj Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për mosraportimin e veprimtarisë publike, takim me punonjësit e Bashkisë Tiranë.
2. Vendosja e sanksionit administrativ ndaj Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, për pengimin e raportimit të veprimtarisë publike, takim me punonjësit e Bashkisë Tiranë.
3. Vendosja e sanksionit administrativ ndaj çdo personi të pa identifikuar deri më tani nga ana jonë, por që me veprime konkrete rezultojn se ka përgjegjësi administrative.

DREJTUAR:

Z. Ilirjan CELIBASHI
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

BAZA LIGJORE:

Nenet 92 dhe 171, të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
Nenet 3 dhe 10, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

I Nderuar Z. Celibashi,

Më datë 27.02.2025, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve ka vendosur shfuqizimin e Vendimit nr. 129, datë 20.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nëpërmjet të cilit, u vendos mospranimi i kërkesës së “Qëndresa Qytetare” për ndalimin e veprimtarisë publike, duke argumentuar se, kemi të bëjmë me një veprimtari të paraportuar, të ndryshme nga

veprimtaria për të cilën është shprehur Komisioneri. Në të tilla kushte, kërkojmë marrjen e sanksioneve ndaj personave përgjegjës.

I. RRETHANAT E FAKTIT

1. Më datë 20.02.2025, Qendra “Qëndresa Qytetare” njoftuar përmes platformave të komunikimit elektronik dhe mediave të ndryshme¹ se, në të njëjtën datë, në orën 16:30, Kryeministri do të zhvillonte një takim me punonjësit e Bashkisë Tiranë. Të dhënat e publikuara tregonin se, në këtë takim do të merrnin pjesë në mënyrë të organizuar dhe të detyruar e gjithë administrata e Bashkisë Tiranë, dhe secili prej drejtorive apo institucioneve në varësi të saj, do të mbajë përgjegjësi për vërtetësinë e numrit të stafit të pranishëm.²

2. Nga verifikimi ynë në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve (“NRI”), rezultoi se kjo veprimtari publike nuk ishte raportuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve [Prova 1 – Raporti i të dhënave mbi aktivitetet publike të administratës shtetërore të raportuara për t’u zhvilluar në datën 20.02.2025 në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve].

3. Sikundër ishte bërë publike, në orën 16:30, ka filluar dhe takimi i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë. Sikundër provohet nga transmetimi i aktivitetit të paralajmëruar në media, për të cilin ka qenë edhe kërkesa jonë, takimi është hapur nga Nënkryetarja e Bashkisë, Znj. Anuela Ristani. Në mënyrë të përmbledhur, ajo falenderon Kryeministrin për takimin, citojmë, të zhvilluar në qiell të hapur, për të mbledhur veten nga ngjarjet, si dhe mungesa e Kryetarit, e cila në vështrim të saj, përbën një sfidë për mbarëvajtjen e punëve publike. Në tërësi, fjalimi i saj adreson mungesën e Kryetarit të Bashkisë, si pasojë e caktimit të masës së sigurimit “Arrest me burg” nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.³

4. Ndërsa Kryeministri e hapi fjalën e tij, duke u shprehur si vijon: *“Të dashur punonjës së bashkisë së Tiranës e kërkoja këtë mbledhje me të gjithë ju sepse gjatë këtyre ditëve kam parë mes jush, por edhe mes shumë të tjerësh njerëz të prekur, njerëz të lënduar, të zhgënjyer, të dëshpëruar. Disa nga ju shkuan dhe tek dera e Gjykatës Speciale për të protestuar ditën që Kryetari i Bashkisë u la në burg pa gjyq.”* Në fjalimin e tij janë mbajtur qëndrime të ngjashme, edhe të një natyre politike, duke përdorur veprimtarinë publike, edhe për të zhvilluar

¹<https://euronews.al/rama-takim-me-punonjesit-e-bashkise-se-tiranes-i-mbledh-ne-sheshin-skenderbej/>; <https://www.balkanweb.com/arrestimi-i-veliajt-rama-do-mbledhe-ne-oren-1630-punonjesit-e-bashkise-ne-sheshin-skenderbej/#gsc.tab=0>; <https://www.syri.net/politike/764602/krim-zgjedhor-rama-mbledh-me-force-per-miting-punonjesit-e-bashkise-se-tiranes-ne-sheshin-skenderbej/>; <https://www.vizionplus.tv/rama-nxjerr-ne-shesh-bashkine-takim-i-hapur-me-te-gjithe-punonjesit-pas-arrestimit-te-veliajt/>; <https://top-channel.tv/2025/02/20/rama-mbledh-punonjesit-e-bashkise-ne-sheshin-skenderbej02/> etj.

² <https://joq-albania.com/artikull/1256344.html>

³ <https://www.youtube.com/watch?v=aj4syitw8RY>

propagandë elektorale [Prova nr. 2 – Fjala e Kryeministrit Rama në takimin me punonjësit e Bashkisë Tiranë].⁴

II. E DREJTA E APLIKUESHME

5. Kodi Zgjedhor:

- (i) **Neni 92** parashikon: “1. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre. 2. Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (...) (...) 6. Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ ose ndërmarrjeve shtetërore, ose zhvillimi i tyre, pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës, si dhe titullarin përkatës të institucionit kur ai ka penguar zbatimin e kësaj dispozite.”.
- (ii) **Neni 171** parashikon: “1. Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë.”.

III. ANALIZA LIGJORE

A. Mbi themelin:

6. Referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Në kuadër të këtij detyrimi, Kodi Zgjedhor ka parashikuar dhe kuptimin e veprimtarive publike. Kështu, sipas Kodit Zgjedhor, formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.

7. Së pari, në rastin konkret, ndryshe nga sa pretendon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, aktiviteti publik i organizuar në orën 16:30, nuk është raportuar nga ana e

⁴<https://www.kryeministria.al/newsroom/fjala-e-kryeministrit-rama-ne-takimin-me-punonjesit-e-bashkise-se-tiranes/>

Kryeministrisë, sikundërse u provua dhe gjatë shqyrtimit administrativ në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve. Edhe sikur t'i referohemi një aktiviteti të pretenduar si të raportuar, por mbi këtë aktivitet janë bërë ndryshime, dhe sikur këto ndryshime të mos ndaloheshin nga Vendimi nr. 9/2020, i Komisionit Rregullator, sërish nuk kemi të bëjmë me të njëjtin aktivitet, pasi aktiviteti, për të cilin pretendohej raportimi nuk do të kishte asnjë pjesëmarrës tjetër përveç Kryeministrit, Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtorit të Fondacionit Anna Lindh Foundation dhe Ambasadorit të Egjiptit në Tiranë [**Prova nr. 3 – Të dhënat e veprimtarisë përkatëse të pasqyruara në NRI**].

8. Së dyti, edhe sikur të abstrahonim nga realiteti dhe të pranohim se, ndodheshim përballë të njëjtës veprimtari publike, personat përgjegjës kanë shkelur sërish legjislacionin zgjedhor. Në referim të pikës 6, të nenit 5, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të dhënat e raportimit nuk mund të modifikohen në periudhën pesë ditë përpara datës së zhvillimit të aktivitetit deri në datën e zhvillimit të tij. Për më tepër që, sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe, fjala “modifikim” nënkupton ndryshimin e trajtës a të diçkaje pa ia ndërruar thelbin, natyrën, duke i bërë ndryshime të pjesshme. Ndërsa në rastin konkret, sikundër është përmendur edhe më sipër, nuk kemi të bëjmë me një ndryshim të pjesshëm, por me një ndryshim tërësor të thelbit të veprimtarisë publike, nga një Ceremoni Hapjeje në një takim publik me punëmarrësit e institucionit, për t'ju ofruar atyre mbështetje, citojmë Kryeministrin dhe Nënkryetaren e Bashkisë, në këto kohë të vështira.

9. Përsa më sipër, duke qenë se veprimtaria në fjalë ka qenë e hapur për mediat dhe për publikun, pra për punëmarrësit e Bashkisë së Tiranës dhe institucioneve a ndërmmarrjeve në varësi të saj, të cilët në formë të organizuar dhe të detyruar kanë marrë pjesë në këtë veprimtari, gjatë periudhës katër mujore përpara datës së zgjedhjeve, dhe zhvillimi i saj nuk është raportuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të pranojë kërkimin për vendosjen e sanksioneve administrative ndaj personave të kallëzuar, si dhe të gjithë personave që gjatë hetimit administrativ do të rezultojnë se kanë përgjegjësi.

B. Në lidhje me masën e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës për raportimin:

10. Referuar pikës 3, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrative të institucioneve publike, agjencie dhe ndërmarrjeve shtetërore. Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve, në referim të nenit 6, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, ngarkon me përgjegjësi administrative personin përgjegjës, si dhe titullarin përkatës të institucionit kur ai ka penguar zbatimin e kësaj dispozite.

11. Në rastin konkret, Sekretari i Përgjithshëm jo vetëm që nuk ka kryer raportimin e veprimtarisë publike, por edhe ka keqinformuar në lidhje me veprimtaritë e planifikuara për t'u zhvilluar nga institucioni i Kryeministrisë, në kundërshtim të hapur dhe flagrant me nenin 92, të Kodit Zgjedhor. Për rrjedhojë, personi përgjegjës duhet të ngarkohet me përgjegjësi administrative sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 171, të Kodit Zgjedhor. Nga ana tjetër, edhe

Kryeministri, përmes veprimeve konkrete, duke organizuar një veprimtari publike të paralajmëruar vetëm një ditë më herët, ka penguar raportimin e veprimtarisë publike, megjithëse ai ka patur në dispozicion të gjitha mundësitë që të njëjtën veprimtari ta zhvillonte dhe në një datë tjetër, duke respektuar nenin 92, të Kodit Zgjedhor.

12. Duke mbajtur në konsideratë rrethanat në të cilat është kryer shkelja e nenit 92, të Kodit Zgjedhor, faktet e mësipërme, si dhe rëndësinë e shkeljes administrative, kërkohet që ndaj personave përgjegjës të vendoset sanksioni administrativ në masën prej 90,000 Lekë.


IV. KONKLUZIONE

13. Përsa më sipër, mbështetur në nenet 92 dhe pikën 1, të nenit 171, të Kodit Zgjedhor dhe në nenet 3 dhe 10, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", të ndryshuar, përfundimisht,

KËRKOJMË

1. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për mosraportimin e veprimtarisë publike, takim me punonjësit e Bashkisë Tiranë.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, për pengimin e raportimit të veprimtarisë publike, takim me punonjësit e Bashkisë Tiranë.
3. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj çdo personi të pa identifikuar deri më tani nga ana jonë, por që me veprime konkrete rezultojnë se ka përgjegjësi administrative.


Me konsideratë,
Për "QËNDRESA QYTETARE"



Dhimitër ZGURO

Bashkëlidhur gjeni:

- (i) Prova 1 – Raporti i të dhënave mbi aktivitetet publike të administratës shtetërore të raportuara për t'u zhvilluar në datën 20.02.2025 në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve;
- (ii) Prova nr. 2 – Fjala e Kryeministrit Rama në takimin me punonjësit e Bashkisë Tiranë;
- (iii) Prova nr. 3 – Të dhënat e veprimtarisë përkatëse të pasqyruara në NRI.



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
RAPORTIM I AKTIVITETEVE

☰ Të raportuara

⚠ Të ndaluara

Veprimtaria



Institucioni

KRYEMINISTRIA

Të dhënat e veprimtarisë

Dt. e regjistrimit të veprimtarisë

14-02-2025, 17:36

Dt. e zhvillimit të veprimtarisë

20-02-2025

Ora e zhvillimit të veprimtarisë

16:00

Vendi i zhvillimit të veprimtarisë

Vendodhja: Brenda Vendit

Qarku: Tiranë

Bashkia: Tiranë

Nj. administrative: Njësia Administrative Nr. 2

Adresa: TKOB

Lloji i veprimtarisë

Tjetër

Tematika e veprimtarisë

Kulturë

Sqarime mbi tematikën

Bashkia e Tiranës organizon ditën e enjte, 20.02.2025, Ceremoninë e Hapjes "Tirana, Kryeqyeti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025".

Tirana është shpallur "Kryeqyeti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025". Ceremonia si dhe shumë aktivitete të cilat do të pasojnë përgjatë vitit 2025 do të nxisin mirëkuptimin midis kulturave si dhe do të promovohen marrëdhëniet mes qyteteve evropiane të Mesdheut.

Folësit kryesorë

#	Emri	Mbiemri	Pozicioni
1.	SHTZ. Edi	Rama	Kryeministër
2.	Z. Blendi	Gonxhja	Ministër

#	Emri	Mbiemri	Pozicioni
3.	Z. Josph Ferre	Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit Anna Lindh Foundation	Tjeter
4.	SHTZ. Hassan	Shawky Ambasador i Egjiptit në Tiranë	Diplomat i huaj

Pjesëmarrës të nivelit të lartë

Veprimtaria nuk ka pjesëmarrës të nivelit të lartë!

Pjesëmarrës të tjerë

Veprimtaria nuk ka pjesëmarrës të tjerë!


Sponsor i veprimtarisë

Veprimtaria e zgjedhur nuk ka sponsor!

Statusi

Statusi i veprimtarisë:

Aktiv




Legjislacioni

- Kushtetuta
- Kodi Zgjedhor
- Ligji partitë politike
- Ligj dekriminalizimi

Transparenca

- Koordinatori
- Programi
- Modelet
- Informacione



NEWSROOM

FJALA E KRYEMINISTRIT RAMA NË TAKIMIN ME PUNONJËSIT E BASHKISË SË TIRANËS

20 SHKURT 2025

Kryeministri Edi Rama zhvilloi sot një takim me punonjësit e Bashkisë së Tiranës në Sheshin "Skënderbej", gjatë të cilit u transmetua edhe një dokumentar mbi transformimin e Tiranës ndër vite.

"Unë jam këtu për t'u thënë të gjithëve ju, se deri kur çështja e Kryetarit të Bashkisë të marrë drejtim, në një mënyrë apo një tjetër, vëmendja ime për Tiranën, për

bashkinë, për problemet dhe punët tuaja do të jetë e pandërprerë." – u shpreh kryeministri Rama në fjalën e tij.

* * *

Të nderuar, të dashur punonjës së bashkisë së Tiranës e kërkoja këtë mbledhje me të gjithë ju sepse gjatë këtyre ditëve kam parë mes jush, por edhe mes shumë të tjerësh njerëz të prekur, njerëz të lënduar, të zhgënjyer, të dëshpëruar.

Disa nga ju shkuan dhe tek dera e Gjykatës Speciale për të protestuar ditën që Kryetari i Bashkisë u la në burg pa gjyq. Nuk dua t'i gjykoj keq, përkundrazi e mirëkuptoj emocionin e tyre por ishte një gabim që sado i pafajshëm nuk duhet të përsëritet më, as nga ju, as nga askush që punon për shtetin shqiptar, në cilindo institucion.

Secili dhe secila prej jush përqafton një skuadër të madhe, një institucion kyç të këtij vendi, një pushtet autonom që, në asnjë mënyrë nuk duhet të shfaqet në institucionin e një pushteti tjetër të pavarur, siç është pushteti i drejtësisë. Që të jemi të qartë unë nuk mendoj shumë ndryshe nga ata që shkuan atje përse i takon ndërprerjes pa gjyq të kontratës së Kryetarit të Bashkisë me qytetarët e kryeqytetit, i cili mbahet sot në burg dhe kjo kampanë bie për ata që duan të dëgjojnë me statusin e "të dyshuarit", por ende jo me atë të "të pandehurit" e lere më pastaj me atë të fajtorit, çka është e papranueshme logjikisht dhe çka është e pashpjegueshme për të gjithë ata çerek e ca milionë qytetarë që e kanë zgjedhur kryetarin e bashkisë që të rrijë në zyrë e jo të mbyllet brenda pa gjyq.



Por ja, ashtu siç ne e transformuam Tiranën, nga një ferr mbi tokë, në një qytet evropian me vizion, me kurajë dhe me mundime shumë të mëdha, ashtu ne kemi vendosur të transformojmë dhe drejtësinë në Shqipëri.

Ashtu siç shembëm ato ngrehinat e shëmtuara që kishin varrosur parqet nën barqet e tyre plot ujëra të zeza, ashtu ne kemi shembur arkitekturën e vjetër të drejtësisë me reformën në drejtësi dhe me vetingun, kemi pastruar një pjesë të rëndësishme të sistemit të kalbur të drejtësisë, të cilin e trashëguam nga ekzaktësisht nga ata që trashëguam dhe Tiranën e 25 viteve më parë.

Dhe tamam ashtu siç na u kundërvunë me dhunën e injorancës së tyre dhe me llumin e kënetës ku kanë 30 e kusur vite që llokoçitën edhe kur nisëm të ndërtonim hyrjen moderne të Zogut të Zi, edhe kur nisëm të ndërtonim sheshin Skënderbej, - duke ua vënë kazmën që të djajve, duke i zëvendësuar me ato shpifësitrat e tyre antiqytet, ashtu duan t'j vënë kazmën dhe reformës në drejtësi, edhe SPAK, edhe llogores tonë të luftës kundër korrupsionit.

Dhe ja ashtu si Roma që nuk u ndërtua në 7 ditë, edhe Tirana e re mori vitet e saj, edhe drejtësia e re do të marrë të sajat. Dhe po ashtu, njësoj si ne, që të gjithë në detyrën tonë bëjmë gabime dhe bën më shumë gabime ai që punon më shumë sesa ai që s'di ccështë puna, dhe organet e reja të drejtësisë nuk ka sesi të jenë të pagabueshme.

Unë e di mirë që gabimet tona nuk shkatërrojnë jetën njerëzish, familje, sipërmarrje ku hyn dhe deri interesa publike, siç ndodh kur gabon drejtësia dhe të kërkossh nga një drejtësi të re në kaq pak vite pavarësi dhe kaq pak kulturë

europiane akoma siç është kjo e jona për më tepër në një klimë të hajvanizuar totalisht nga prokurorët televiziv, nga gjykatësit digjitalë dhe nga opozitarët kallajdalë, që të mos gabojë është njësoj si të hedhesh një fëmijë në ujë dhe t'i thuash "mos u lag".

Por nuk ka asnjë alternativë të ndarjes me historinë 100 e kusur vjeçare të pandëshkueshmërisë pa marrë përsipër edhe kostot, kostot politike, kostot morale, kostot njerëzore të dëmeve kolaterale të një përmbyse si kjo, që ne kemi udhëhequr me reformën ne drejtësi dhe që nëse duam që Shqipëria e nesërme të jetë e drejtë dhe e barabartë me të gjithë sicc është Tirana sot europiane për të gjithë, atëherë duhet të shtrëngojmë dhëmbët, duhet të durojmë dhe duhet të vazhdojmë të luftojmë.

Nganjëherë këto dëme janë sa të dhimbshme dhe të padrejta, po kush udhëheq nuk duhet të lëkundet nga asnjë dhimbje në rrugën e drejtë të përmbyshjes së vizionit, të cilin kanë zgjedhur. Përndryshe asgjë nuk ndryshon ose më keq akoma ndryshon për keq, degradon, kalbet siç u kalb Tirana.

Kur në vitin 2000 unë hyra në bashki dhe kishte vetëm 78 llamba neoni që ndizeshin akoma në rrugët e saj, parafytyroheni pak ju që jeni më të rinj këtu dhe le ta parafytyrojnë të gjithë ata që jetojnë ku e ku më mirë sesa jetohej dje dhe pa asnjë turp thonë |: ju jeni të gjithë njësoj, këtu është bërë keq e më keq. 78 llamba neoni fiks, asnjë më shumë. Dhe nga ndërprerjet e pafundme të energjisë elektrike e nga kandilat që njerëzit linin nëpër dritare Tirana dukej natën si një varrezë, qytet varresh murale.

Që ta mbyll këtë parantezë, nuk më takon mua të them nëse lali Eri është i pafajshëm apo është fajtor dhe pavarësisht se çfarë mendojmë ne këtu, barra ime është që në këtë detyrë të qëndroj mbi opinionin tim edhe në këtë rast dhe t'ja lë drejtësisë ta ndajë këtë dilemë, duke mbështetur plotësisht pavarësinë e organeve të drejtësisë ndërsa barra juaj, e përbashkëta, është që makineria e Bashkisë së Tiranës të mos fiket asnjë minute, por të vazhdojë të xhirojë 24 orë në të gjitha drejtimet. Unë jam këtu për t'ju thënë të gjithëve ju, se deri kur çështja e kryetarit të bashkisë të marrë drejtim, në një mënyrë apo në një tjetër, vëmendja ime për Tiranën, për bashkinë, për problemet dhe nevojat e punës suaj do të jetë e pandërprerë. Uroj dhe dua të besoj akoma se përtej asaj çka mendojnë për fajësinë e tij, organet e drejtësisë do t'ia japin kryebashkiakut të Tiranës të drejtën më elementare të një gjyqi dinjitoz, duke i dhënë fund praktikës brutale të prangave pa gjyq për kryebashkiakë dhe punonjës shteti në detyrë, kur as janë kapur në flagrancë, as paraqesin ndonjë rrezik arratisjeje, as nuk kanë çfarë provash të prishin.

Ama, përtej kësaj çështjeje specifike që është e drejtësisë e jo e jona, askush dhe asgjë, as një buf dhe asnjë specie tjetër e kënetës së madhe politike dhe mediatike të këtij vendit tonë nuk e mbulon dot me shoshën e blozës dhe të llumit diellin e transformimit kolosal, historik në plot kuptimin e fjalës të Tiranës sonë, ku pa mua që e nxora nga koma nën rrënoja, e pastrova nga llumi dhe e ngrita në këmbë me mbështetjen e pakursyer të popullit të Tiranës dhe të Partisë Socialiste të Shqipërisë, të socialistëve dhe progresistëve kryeqytetas dhe pa lali Erin që e bëri të vrapojë dhe të kthehet në një destinacion turistik gjithë vjetor, me mbështetjen e pakursyer të të gjithëve ne, ky qytet nuk do ishte dot kurrë vendi ku sot shëtisin si europianë që të gjithë, opozitarë, prokurorë, gjykatës, analistë, gjithlogë, gazetarë,

gytetarë dhe shkojnë e vijnë në punën e tyre duke i çuar fëmijët në çerdhe, duke i çuar fëmijët në kopshte, duke i çuar fëmijët në shkolla që nuk i lënë gjë mangut shkollave të Bashkimit European dhe duke i çuar të afërmit, kur larg qoftë është nevoja, në një spital që nuk i lë gjë mangut spitaleve të Bashkimit European, duke shëtitur nëpër parqe bashkë me prindërit e tyre pensionistë e duke dalë dhe për vrap nga Liqeni, në një park si parqet në Europë dhe jo si ai parku ku u zhvillua lufta e fundit civile e Tiranës midis disa specieve të kënetës opozitare të armatosur me pistoleta dhe policëve bashkiakë për t'i hapur rrugë një këndi lodrash.

Kurrë nuk bëhej Tirana vendi ku në 16 maj do të mblidhen 46 udhëheqës të kontinentit european dhe 8 udhëheqës të institucioneve më të larta ndërkombëtare, nga udhëheqësit e Bashkimit European tek ata të NATO-s.

Unë i falënderoj vajzat dhe djemtë që patën mirësinë të mendonin dhe të realizonin këtë video-kujtesën që sapo ndoqëm.

Kënetat thotë se Tiranën moderne e bëri koha ndërsa përmbajtjet apo çfarëdo tjetër që nuk shkon i bën bashkia por jo; Tiranën moderne nuk e bëri koha. Tiranën moderne e bëme ne, Tiranën moderne e bëra unë, e bëri lali Eri, e bëti ju, e bëne grupet e këshilltarëve bashkiakë socialistë dhe progresistë, e bëne të gjithë ata që në 24 orë për vite e vite me radhë ndërrojnë turnet që Tirana të gdhihet e pastër dhe aq e pastër sa që të gjithë turistët që vijnë thonë "Ua, ç'është ky kryeqytet kaq i pastër", Tiranën e bëne ata që na dhanë besimin me votë, 7 herë në 7. Në atë herë të vetme nga të shtata, kur bashkinë e mori kënetat ashtu sicc e mori në 2011, koha ngeci, edhe vetë sahati i Tiranës ndaloi dhe kryeqyteti rinisi të marrë erën e kuzanëve të plehrave ndërsa rrugën nisën t'u hapen gropat në trup.



Më kujtohet njëherë i them berberit "Ore të duket ty sikur ka filluar të marrë prapë erë kazanësh Tirana"? "Nuk janë kazanë more shef, ashtu i vjen era e sjetullës këtyre që kemi në pushtet". Muhabet berberësh, por në këtë rast më duket i qëlluar, apo jo?

Se kjo e Tiranës dhe e Shqipërisë nuk është një punë që mund ta bëjnë ata që duan, por që nuk dinë, nuk dinë asgjë tjetër, përveçse të shajnë dhe të akuzojnë nëpër foltore. Ai Komisioni Hetimor që u ndërtua atëherë në 2002 apo kur ishte, erdhi pas një lemerie akuzash.

Kjo puna e Tiranës, por edhe e Shqipërisë nuk është për ata që e komentojnë dhe nuk dinë se çfarë flasin, ku çfarë nuk dërdëllisin e çfarë nuk sajojnë ulur në ekran si nëpër qebaptore dhe mbi të gjitha, kjo puna e Tiranës dhe e Shqipërisë nuk është për xhuxhmaxhuxhët mendorë që kur shohin kulla mendojnë para, që kur shohin rrugë mendojnë vjedhje, që kur shohin parqe mendojnë korrupsion dhe mbi të gjitha, që kur shohin të bukurën ndjejnë urrejtje dhe urrejtja i shtyn pastaj të gërmojnë për të kërkuar qenin e ngordhur.

As politikanëve, as analistëve apo zhurmalistëve të kënetës, që paratë për vete i marrin së shumti në të zezë se nuk duan të paguajnë taksa dhe sigurime të larta kur shajnë qeverinë nëpër ato banaqet se pse nuk i rrit pensionet, nuk ia rrok truri se mund të ekzistojnë njerëz që nuk marrin lekë kur japin leje ndërtimi, por ama i kërkojnë biznesit pemë, për shembull, për qytetin.

Ato ndërtimet që u prishën në Lanë atëherë, e dini ju si janë prishur dhe si është pastruar një sasi rrënojash që kapi volumin 138 mijë ton beton? Janë prishur me

korruption, kam bërë unë korruption, i kam thirrur ndërtuesit në zyrë këtu dhe i kam thënë "Ore keni dhënë ndonjë lek ju për lejet e ndërtimit?"

Ata shikon dhe thonin "Çfarë, si është puna?"

-Ore përgjigjuni, a keni dhënë ndonjë lek për lejet e ndërtimit?

-Ti ke dhënë? Jo

-Ti ke dhënë? Jo.

Po mirë, më dini budalla mua, – i thashë, – që merrni leje ju dhe nuk jepni asgjë?

Atëherë i thashë ka ardhur koha që t'i paguani rryshfetin qytetarëve të Tiranës. Ua ndava segmentin e Lanës me copa, i thashë "Merrni buldozerët tuaj, merrni punëtorët tuaj, merrni naftën tuaj, shkoni, prisheni dhe pastrojeni se përndryshe nuk merrni më leje ndërtimi".

Në vijën logjike të një sërë hetimeve intensive, jam gati të dorëzohem përpara drejtësisë. E kam bërë këtë dhe nuk e kam bërë njëherë, e kam bërë shumë here, por ata që dje në çdo pallat të ri shikonin përqindjet për leje ndërtimi dhe kur unë i thash "Nuk ka bir k.. dhe nuk ka bir nëne që të dalë dhe të thotë që më ka dhënë mua lekët"..më nxorën dhe një burrë që më ka kërkuar fajle një 34 herë deri tani, edhe e kam falur 38 herë po ai vazhdon më kërkon fajle. Edhe kur shohin kulla, të njëjtën gjë mendojnë, vetëm se sa përqindje merret nga këto lejet e ndërtimit?! Ndërkohë që një ndër politikanët e "kënetës", se ata ashtu e kanë kokën, dhe atë pjesën e pjesës e kanë kuptimin parësor të pushtetit se ai "Zogu i Zi" që ta dini ju,

kishte brenda dhe një pjesë të pjesës kur u sulmua dhe u prish, siç e patë, me vlerësimin me të mirë të ekspertëve më "të shkëlqyer" të vendit, po as këta zhurnalistët nuk i dëgjova kurrë që të thonë një gjë shumë të thjeshtë; "po mirë, meqë nga këto kulla dhe nga ndërtimet u merka gjithë kjo para e madhe për korrupsion, çfarë është kjo taksë e Bashkisë së Tiranës", që është sa frëngu pulën. Në 10 vitet e fundit të ardhurat e bashkisë së Tiranës dhe këtë duhet ta dëgjojnë të gjithë ata që i çojnë fëmijët në shkollë, në këto shkollat evropiane, duhet ta dëgjojnë të gjithë ata që i çojnë fëmijët në ato kopshtet dhe në ato çerdhet; duhet ta dëgjojnë të gjithë ata që dalin në parqe; duhet ta dëgjojnë të gjithë ata që kur kthehen nga puna i thonë babës "si kalove sot nga liqeni"- janë rritur nëntëfish, kanë qenë 30 milionë euro kur bashkia gërrhiste, vjet 271 milionë euro të ardhura.

Tani dëgjoni se sa para ka marrë Bashkia e Tiranës nga të pasurit, nga këta, nga ata që ndërtojnë për lejet e ndërtimit. Me taksën e gërrhjes dhe të ekspertëve "të shkëlqyer" bashkia mbledhte 930 mijë euro në vit, pjesën e pjesës e dinë ata, unë s'e di.


Unë di pjesën që merrte bashkia kur me propozim të Erjonit taksa u rrit në 2016, filloi që në 2016 dhjetëfish, jo 900 mijë, po 9 milionë euro, ndërsa në 2024 janë mbledhur 157-fish, domethënë 146 milion euro vetëm nga taksat e ndërtimit dhe atyre që thonë s'duam kulla, s'duam beton, s' duam pallate i them; Po rrugë doni? Po blloqe të reja doni? Po kopshte doni? Po çerdhe doni? Po shkolla doni? Po korsitë biçikletash doni? Po autobusë ku sot pensionistët lëvizin falas doni? Po kartë studentit doni? Po ushqim për fëmijët në shkollat 9-vjeçare falas doni? I doni këto? Me çfarë këto? Duke rritur bar në sheshin "Skënderbej"? Se kishte dhe ca që thanë

“na e betonizuan sheshin”, po ata i mirëkuptoj se janë delet e kënetës, që bëjnë be-be kur kënetë bën kua-kua-kua dhe kur bufi del u-u-u.

Dhe totali që bashkia ka marrë se kur sheh se nga e kemi nisur, nga ai ferr, nga ajo çmenduri që e quanin dhe qytet, po ç’të presësh nga ata? Po ç’a të presësh nga ata kur bufi i tyre thoshte: “ju- atyre atje, që i lanë rrugëve dhe shqyrr që erdhi Rakip Suli dhe i nxorri nga balta – ju keni ba mrekuillinë e tetë t’botës, keni ndërtu qytetin e parë pa leje në historinë e njerëzimit”. Ç’a të presësh nga këta? Nga këta anti-urbanë, nga këta anti-qytet, nga këta anti-evropianë? Nga këta squetull-kazanë? Ç’a të presësh? Gjysmë milionë dollarë ka mbledhur bashkia e Tiranës nga viti 2016 deri në vitin 2024 nga taksa e ndërtimit vetëm, normal pastaj që investimet publike që në kohën e “gërrhimës” ishin 10 milionë, në tre vitet e fundit kanë qenë mesatarisht nga 100 milionë.

Ky quhet vizion, vizion ardhmërie, ky quhet program, program shpëtimi nga historia e një kënete 500-vjeçare; program rritjeje ekonomike dhe sociale, ky quhet lidership dhe kështu është kur kush fiton më shumë, paguan më shumë, oligarkët, oligarkët dhe oligarët. Oligarkët e syve që t’u plaçin zhabave, zhapikëve dhe bretkosave të kënetës. Se çfarë i paguajnë këtu më të pasurit buxhetit të shtetit dhe buxhetit të bashkisë në 1 vit, nuk ia kanë paguar “kënetës” për shtetin se për “kënetën” nuk di unë se ç’a kanë paguar, që kur ekziston “kënetë”.

Dhe kështu është kur me taksat e mbledhura bëhen politikat e duhura dhe qytetarët dhe qyteti si pronë e përbashkët marrin mbrapsht atë që iu takon nga zhvillimi i pronave të përveçme dhe ta mësojnë të gjithë, ta mësojnë të gjithë ata që duhet ta dinë mirë përpara se të hapin gojën dhe të flasin për leje ndërtimi



sidomos ata që duhet të zbatojnë ligjin apo duhet të ndjekin zbatueshmërinë e ligjit, lejet e ndërtimit nuk janë privilegje, lejet e ndërtimit nuk janë indulgjencia, lejet e ndërtimit nuk janë favore që i bën kryetari i bashkisë, lejet e ndërtimit janë të drejta zhvillimi të pronarëve dhe të investitorëve se bashku. Dhe cilido, kudoqoftë dhe akuzon për ryshfet në dhënien e lejeve të ndërtimit pa prova, thjesht ose e ka bërë vetë ose do ta bënte vetë po ta kishte në dorë.

Kur unë erdha në bashki, dëgjojeni këtë se është e bukur kjo, doja të fusja ngrohjen qendrore në shkolla po atëherë shkollat vareshin nga qeveria dhe ministri i kohës, i Arsimit tha jo.

“Ne i kemi klasat -tha- me shumë nxënës, me shumë turne dhe ata mund të ngrohen me sobë dhe me frymën e njëri-tjetrit”.

Dhe duke folur për shkollat, unë do i bëja një thirrje publike sot, kujtdo që e pranon sfidën. Ma gjej një shkollë, një të vetme që të jetë ndërtuar apo rindërtuar kur “kënetat” ishte në pushtet, ishte në qeveri, ishte këtu në Tiranë, në çdo qytet dhe që sot të mos jetë rindërtuar dhe nga ana tjetër, më gjeni një shkollë të re të ndërtuar në dekadën e fundit, ku të doni, Tiranë, Durrës, ku të doni që mos jetë njësoj si shkollat në Europë. Ky është dallimi midis dy botëve tona dhe ky është dhe dallimi midis atyre që luftojnë për një kauz, për një mision. Se Tirana është mision. Shqipëria është mision dhe atyre që urrejnë.

‘Adopto një çerdhe’ ishte programi që ishte shumë i ngjashëm me atë ‘Adopto një segment të Lanës’ apo ‘Adopto një trotuar dhe mbill pemë’, janë 55 mijë pemë dhe shkurre dekorative që kemi mbjellë në Tiranë deri në 2011. Besoj që nja 80% kanë

qenë me korrupsion, besoj, duke ua kërkuar kompanive, duke ua kërkuar firmave të ndërtimit, duke ua kërkuar bankave. Ja kështu siç ua thashë më përpara. Ke dhënë ndonjë lekë ti për mua? Po më di budalla?! Shko mbill pemë.

“Adopto një çerdhe” ka bërë që në Tiranë një numër i madh çerdhesh të jenë bërë pa buxhet të taksapaguesve dhe janë bërë nga kompanitë, janë bërë nga sipërmarrjet. Me korrupsion. Dhe përveç taksës së ndërtimit, ka dhe një taksë tjetër brenda. Këtyre këtu, atyre atje, gjithë këtyre kullave dhe këtyre ndërtimeve të të pasurve. Duhet ta mësojnë të gjithë se nuk ua thotë dot kënetat, nuk ua u thonë dot zhurnalistët, nuk ua u thonë dot ata që ulen si ndërtime pa leje nëpër studio televizive. 3% e taksës ekstra shkon për strehim social. 3%. Pra paguajnë dhe 3% detyrim mbi detyrimin e taksës, me të cilët pastaj bashkia, jep strehime sociale dhe prandaj nuk është e çuditshme që në bashkinë e Tiranës, ne kemi numrin më të madh të familjeve që kanë marrë subvencionim të interesave të kredive. Janë rreth 4 mijë familje, apo kanë përfituar direkt nga ky kontribut i atyre që bëjnë kulla dhe që bëjnë ndërtime të tjera.

Janë shumë gjëra për tu thënë, por unë nuk do të ndalem më tutje te këto, sepse dua ta mbyll fjalën time duke thënë që në vitin 2022, Tirana u bë ‘Kryeqyteti evropian i rinisë’. Parafytyroni atë ferr ku ne ndërmorem këtë rrugë, ‘Kryeqytet evropian të rinisë’. Parafytyroni kryeqytetin evropian të Sudes, të Xhaferit, të Gjallicës e të Buallicës, ‘Kryeqytet evropian të rinisë’. Pastaj u bë, në 2023-shin, ‘Qytet evropian i sportit’. Parapërfytyroni Tiranën ‘Qytet evropian i sportit’ në një vend ku kënetat mbyllli fiskulturën. Nuk kishte më Edukim Fizik nëpër shkolla. U zhdukën dhe trajnerët. Dhe kur ne morëm detyrën, palestrat në Shqipëri, jo në Tiranë, në Shqipëri numëroheshin me gishtat e dorës në 2013-tën. Me gishtat e

dorës! Ishin akoma ato 3-4 palestra epike të kohës së komunizmit. Sot nuk ka shkollë pa palestër në Tiranë dhe janë palestra moderne dhe ne nuk ndërtojmë më shkollë pa palestra në Shqipëri dhe kështu i kemi futur 12 mijë fëmijë në Lëvizjen Sportive, pa llogaritur se sa e sa të tjerë bëjnë stërvitje në 66 shoqatat sportive që ka bashkia e Tiranës. 54 palestra që funksionojnë çdo pasdite ka bashkia e Tiranës, të gjitha të mbështetura nga bashkia e Tiranës.

Këneta kishte lajmëruar, nuk e di a e patë, që këtu do të bënim një anti miting, punonjësit e bashkisë me mua në krye, madje e kishin bërë dhe njoftimin "U çmend Edi Rama". E keni parë si i bëjnë titujt 'plasi', 'shpërthehu', 'u çmend', 'shokoi', 'tronditi', 'ra'. I keni parë titujt? Lexon titullin, thua çfarë po ndodh, futesh brënda 'noc rroku'.

Tani e keni parë, kanë mësuar dhe 'noc rrokun' dhe ma thonë mua "noc rrokun", "noc rrokun", , por nuk e dinë që "noc rroku" është kur e ndien jo kur ta thonë. Kur e ndien është muhabeti si i bëhet "nocit", se kur ta thonë, kështu që ja, do vijë 'noci' bashkë me pranverën. E keni dëgjuar atë këngën 'ty edhe pranverën ju kam pritur, të më vini pa trokitur', kështu do tu vijë 'noci'. Anti miting që do të protestonin për të burgosurin politik Erion Veliaj.

Tani edhe në këtë rast, ata në fakt si në çdo rast po ta shikoni, edhe kur shpifin nisen nga vetja, se ata kanë nja 3-4 të burgosur politik dhe prandaj dhe vetëm lënë nam dhe zgarazhubraviten me turp sepse në vend që të mësojnë nga më të mirët, duan të na bëjnë dhe ne si veten. Po në Shqipëri nuk ka të burgosur politik që nga viti 1997-të, kur doli dhe i fundit nga burgu, që e kishte mbyllur 'këneta' brenda ndërkohë që qeveritë që bënin antimitingje? Dhe nuk di pse thonë anti

miting, nuk thonë miting, se anti miting çfarë do të bëjmë ne këtu? Kush bëri miting që ne të bëjmë anti? Po ata si duket anti mitingun e kanë brandin e vetë dhe nuk e lëshojnë.

Pra qeveritë që bënin anti mitingje kanë vdekur, kanë vdekur fiks në vitin 2013 bashkë me ideatorët e tyre që tani kanë statusin monumente të opozitarizmit kënetor. Unë e kërkova këtë takim me ju këtu në këtë mexhllis të madh të shtëpisë që juve ju ka shërbëtorë për t'ju thënë që duhet të jeni shumë krenar për punën tuaj, duhet të jeni shumë krenar për mundin tuaj, duhet të jeni shumë krenar për sakrificën tuaj dhe për t'ju thënë se nesër kur të gjitha llafet t'i marrë era dhe të gjithë specieve të kënetës ti jetë harruar emri, kur të gjithë të vërtetat dhe gënjeshttrat të jenë ormisur në vendet e tyre dhe të gjitha vajtjet e merituara apo të pa merituara të kujtdo që ishte në arenë në kohë plot me gojë të shturura dhe me mendje të pagdhendura të kenë mbaruar, kur projektet tona ende në rrugë apo në letër të kenë mbaruar dhe të tërë ju këtu që jeni dhe më të rinj do ta jetoni Tiranën e Re të ëndrrave, të mendjeve, të punëve dhe të mundimeve tona të përbashkëta do të keni një krenari shumë më të posaçme sesa gjithë të tjerët dhe do të keni një siguri shumë të madhe që Zoti nuk ju solli kot në këtë jetë por i dhatë një dorë vendlindjes tuaj dhe vendlindjes së fëmijëve tuaj për historinë.

Dhe unë ju kërkova për t'ju thënë dhe pse deri atëherë kemi ende ca punë për të bërë, kemi projekte për të realizuar, kemi beteja për të fituar sepse ndërkohë qyteti bëhet më i madh, bëhet më kërkues, bëhet më i paduruar për tu ngjitur në majën e Shqipërisë 2030 ku Shqipëria do marrë jo vetëm nurin por dhe vullën e Europës, të Ballkanit dhe Tirana do krenohet si kryeqytet i saj.

Tani disa më pyesin çfarë dua unë akoma që nuk iki. Ca të tjerë përgjigjen: nuk ikën ai se është i pangopur. Nganjëherë në fakt, jo shpesh por nganjëherë kur llumi, helmi, zhurma bëhet një potere e madhe e pyes dhe unë veten, ore çfarë dua unë akoma që rri dhe mbaj gjithë këto jashtëqitje gojësh të shthurura, mendjesh gjysmake dhe shpirtrash të varfër mbi fytyrë. E për çfarë arsye duhet që familja ime të durojë gjithë këtë qenëri mesjetare. Por përgjigja është sa e thjeshtë aq dhe e pakundërshtueshme brenda meje. Nuk iki sepse unë kam një luftë për të mbaruar. Dhe e dini se nuk e kam thënë ndonjëherë, mua më ka futur në këtë luftë shiu dhe balta e varrezave të sharrës. Kur erdha atëherë nga Franca për të përcjellë tim atë dhe u kthyem në shtëpi nga varrimi, sikur ishim kthyer nga lufta me baltën deri afër gjunjëve. Dhe prandaj aty nuk i ika dot tundimit që t'i thoja po thirrjes së kahershme të Fatos Nanos për tu përfshirë në qeveri, që deri aty as e kisha marrë ndonjëherë në konsideratë. Pastaj rruga e jetës politike por unë besoj më shumë fati i shkruar mua më nxori në krye të Bashkisë së Tiranës, tamam kur ishte mbledhur gjithë balta, gjithë llumi, gjithë pluhuri i gjendjes natyrore të një lirie pa shtet, pa ligj, pa kontroll dhe të një qyteti që ishte kthyer në tokë të askujt me bekimin e bufit të kënetës ku pushtohet çdo pëllëmbë e lirë dhe pemët binin përditë si ata robërit kur i pushkaton: bam bam bam! Dhe kur i shoh sot ato pemët e mbjella aso kohe që janë rritur në asket kryesore të Tiranës së atëhershme them se edhe për aq do ia kishin vlejtur gurët, do ia kishte vlejtur balta që kam ngrënë që atëherë. Që edhe mbjelljen e pemëve tek ai komisioni hetimor që patë në televizor besoni ose jo ma kanë quajtur pastrim parash të drogës, pemë për pemë, tek kumbullat e kuqe pastrim i parave të drogës. Imagjinojeni sa vite ka ky avaz por sot që ka shumë më shumë se aq për të parë, Tirana është për mua prova se siç kjo luftë e pafundme përballë gjithë fare horrash dhe gjithfarë horrilëqesh nga të katërta anët, nga ata horra dhe ato horrilëqe që nuk e lanë këtë vend të ngrinte

kokë as kur ngriti flamurin e pavarësisë që nuk ju ndanë këtij vendi që nga viti 1912, sot e ka bërë qytet europian kandaharin e vitit 2000 dhe filks si ajo luftë ashtu dhe lufta e pafundme përballë Ilumit të një kënetë gjithë-politike dhe mediatike dhe një deti paragjykimesh për Shqipërinë dhe për shqiptarët do ta bëjnë Albania-n shtetin e ri të Bashkimit European në 2030 dhe kjo e imja është një luftë me historinë dhe është një luftë për historinë dhe ky është një moment kur yjet e Shqipërisë janë rreshtuar për së mbari. Ama na takon ne që këtë moment ta kthejmë në një shenjë të përhershme në flamurin e Bashkimit European duke i bërë të gjitha gjërat e duhura me kohën që kemi në dispozicion deri ditën e anëtarësimit që është më afër se kurrë ndonjëherë dhe mos e harroni dhe një gjë tjetër; për ne shqiptarët, për Shqipërinë, anëtarësimi në atë familje është mbi të gjitha çështje dinjiteti, dinjiteti që na u nëpërkëmb me dhjetëra e qindra vite, edhe për fajin tonë pa diskutim. Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin European, ai emri "Albania" aty në tryezën e gjithë atyre që i kemi parë dikur me dylbi dhe që na kanë parë për kaq kohë nga lart poshtë, është hakmarrja e çdo shqiptari të sotëm që është patriot për të gjitha poshtërimet që na i kanë bërë të huajt dhe vetëposhtërimet e të gjitha kohërave që na kanë bërë bufat dhe jashtëqitjet e kënetës ndër shekuj dhe që nga viti 1912 dhe kjo është e vërteta dhe e vërteta duhet thënë me fjalët siç i takon në gjuhën e bukur, të ëmbël dhe kuptimplotë shqipe.

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin European kalon nga Tirana që është lokomotiva e transformimit historik që duhet të vazhdojë me ju në pararojë, që nga skuadra e zëvendës kryetareve dhe zëvendës kryetarit këtu e deri tek lulishtarët, fshesarët, policët bashkiakë dhe i gjithë punonjësvë të tjerë të Tiranës.

Këta muaj bashkia e Tiranës duhet të zgjohet edhe më herët se ç'zgjohet dhe të flejë edhe më vonë se ç'flinte kur që mësuar me mua dhe pastaj kur e rimësoi dhe lali pasi e futi në gjumë, ky figura që tani i është harruar edhe emri.

Tirana ka zgjedhje për të mbajtur në 11 maj, por ama bashkia e Tiranës ka miq të mëdhenj për të pritur në 16 maj. Kështu që, çdo gjë duhet të shkëlqejë dhe gjithkush nga ju duhet të japë më të mirën e vet.

Unë do të jem këtu me ju dhe për ju me Tiranën për gjithë Shqipërinë. Ditën dhe natën me kokën lart, me mendjen e ndarë, me zemrën në vendin e duhur dhe bashkë me çdo shqiptar e shqiptare që flamurin nuk e ka vetëm për në stadium por e ka në zemër, e ka në mendje dhe e ka në dritën e syve të vet që nga Tirana e të gjitha prejardhjeve e deri tek Shqipëria që sytë i ka tek Tirana.

Çfarë nuk të vret, të forcon. Ditët më të mira janë të gjitha përpara!

